



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration*

Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL
Përmes: <i>PER:</i>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Venera Çerkini, U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Vitisë
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

1. Vendim Nr. 01-410/03-1278 për ndryshim plotësim të vendimit nr. 01-410/03-71, të datës 08.02.2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
I miratuar më datë: 03.12.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.12.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojnë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Pravno odeljenje i nadgledanja opština / MALS-a	
Preko: ZA:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Čerkini, U.D. v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS	Datum: 10/12/2018
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Vitina	020/1405
Vrsta akta:	Odluke	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i nadgledanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

1. Odluka 01-410/03-1278 o izmeni i dopuni odluke br. 01-410/03-71, datum 08.02.2018 opštinskog odbora za bezbednost zajednice
Usvojena dana: 03.12.2018
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 05.12.2018

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja gore navedenog akta opštine, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog gledišta u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravne efekte. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

04-12-2018



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-076, për policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr 27/2012 MPB, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 36 shkronja d, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë mbledhjen e mbajtur më datën 03.12.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Me këtë Propozim Vendimi Kryetari i Komunës së Vitisë propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë.

Neni 2

Konformë Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 pika 1.8 të Republikës së Kosovës të datës 22.02.2012, Kryetari i Komunës propozon Kuvendit Komunal të Vitisë ndryshimin e vendimit të datë me nr. 01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që anëtarin Zeqir Sadriu si Kryetar i Këshillit të Prindërve të lirohet nga detyra e anëtarit të KKS-së dhe të zëvendësohet me z.Avdyl Misini, i cili është zgjedhur Kryetar i Këshillave të Prindërve.

Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë mbeten në fuqi.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Anëtarëve të KKS-së,
3. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

Kuvendi i Komunës së Vitisë

Kryesuesi

Naim Pira


Gafurr Sllamniku

From: Ilir Zuka
Sent: 11. decembar 2018 10:04
To: Gafurr Sllamniku
Subject: Komuna Viti
Attachments: permirsim i vendimit të KKSb-së.pdf

Pershendetje Gafurr ne atash ke vendimin qe e diskutuam dje kemi bere permirsimin e vendimit qe ka qen gabimi te neni 1 , gjithashtu nese ke mundesi nje numer kontakti se desha me u konsultu diqka me nje vendim tjeter gjitha te mirat per ju nga Ilir Zuka - Kuvendi Komunal Viti



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-076, për policinë, dispozitave të nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr 27/2012 MPB, 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe nenit 36 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 03.11.2018, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim plotësim të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për ndryshim plotësimin e Vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë.

Neni 2

Konformë Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 pika 1.8 të Republikës së Kosovës të datës: 22.02.2012 Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton ndryshimin e vendimit me nr. .01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që anëtarë Zeqir Sadriu si Kryetar i Këshillit të Prindërve të lirohet nga detyra e anëtarit të KKS-së dhe të zëvendësohet me z. Avdyli Misini i cili është zgjedhur Kryetar i Këshillave të Prindërve.

Neni 3

Të gjitha pjesët tjera të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi pranë Komunës së Vitisë mbeten në fuqi.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Anëtarëve të KKS-së ,
3. MAPL-së, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Naim Pira

